



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Aplikimi i Ngarkesës së kundërt të TVSH-së për shërbimet e blera jashtë Kosovës

Nëntor, 2017

Personat e obligueshëm për të paguar TVSh-në

- Personi që zhvillon furnizim të tatueshëm të mallrave / shërbimeve, përjashtim aplikimi i ngarkesës së kundërt
- Personi i cili prezanton TVSh-në në një faturë
- Në importime
- Personi që bën që mallrat të pushojnë nga depot doganore, etj.
- Emërtimi i përfaqësuesit tatimor



Personat e obliguar për të paguar TVSh

- Çdo person i tatueshëm që zhvillon furnizim të tatueshëm të mallrave ose shërbimeve, me përjashtim kur TVSh duhet të paguhet nga personi tjetër duke aplikuar Ngarkesën e kundërt të TVSh-së.
- Çdo person i cili është regjistruar për qëllime të TVSh-së në Kosovë të cilit i janë furnizuar mallrat dhe shërbimet nga personi i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë, duhet të aplikoj Ngarkesën e Kundërt për TVSh.



Personat e obliguar për të paguar TVSh

- Çdo person i cili prezanton TVSh-në në një faturë.
- Në importime, TVSh duhet të jetë e pagueshme nga çdo person ose nga personat e caktuar apo të njohur si obligues.
- Nga çdo person i cili bën që mallrat të pushojnë së përfshiri në depot doganore,



Personat e obliguar për të paguar TVSh

Personi i tatueshëm i cili nuk është i vendosur në Kosovë, duhet të emëroj **Përfaqësuesin Tatimor** si person të obliguar për të paguar TVSh-në, në përjashtim për rastet e përkufizuara në nëparagrafin 1.2 dhe 1.3 të Nenit 52 të Ligjit për TVSh, kur pranuesi është i obliguar të paguaj TVSh-në.



Orientimi fillestar për Ngarkesën e Kundërt

Orientimi fillestar për Ngarkesën e Kundërt është:

- Neni 19 i Ligjit për TVSh-në që rregullon vendin e furnizimit të mallit, dhe
- Neni 20 i Ligjit për TVSH që rregullon vendin e furnizimit të shërbimit.



Kur Pranuesi i shërbimit **ËSHTË** i regjistruar për TVSh në Kosovë

Është i detyruar të paguajë TVSh-në

Sipas Nenit 52 të Ligjit për TVSh, **personi i obliguar të paguaj TVSh-në** është personi i cili kryen furnizime të tatueshme. Sidoqoftë, kur furnizimi kryhet nga një person i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë tek një person i cili është i regjistruar për TVSh në Kosovë, personi që ka për detyrim të paguajë TVSh-në mbi atë furnizim, **është pranuesi e jo furnizuesi.**



Faturimi

- Edhe pse furnizuesi nuk është i obliguar të paguajë TVSh-në, ai përsëri është i obliguar të lëshoi një faturë në pajtim me Nenin 45 të Ligjit për TVSh.
- Furnizuesi duhet të cekë në faturë se klienti është i obliguar të paguajë TVSh-në duke e vendosur aty referencën e Nenit 52, paragrafi 2 të Ligjit për TVSh apo ndonjë referencë tjetër, që tregon se furnizimi do t'i nënshtrohet procedurës së **ngarkesës së kundërt**. Teksti në vijim do të konsiderohej si i duhur: *“Ngarkesa e kundërt, nënparagrafi 1.2 i Nenit 52 i Ligjit mbi TVSH-në në Kosovë”*.



Llogaritja e TVSh-së

Pranuesi i furnizimit duhet të llogarisë TVSh-në mbi të dhënat e faturës së pranuar nga furnizuesi. Sidoqoftë, pranuesi duhet të sigurohet se baza tatimore llogaritet në pajtim me Nenin 24 të Ligjit për TVSh. Rrjedhimisht, pranuesi duhet të sigurohet se baza tatimore përfshin çdo gjë që përmban konsideratën e fituar ose që do të fitohet nga furnizuesi, në kthim të furnizimit.



Llogaritja e TVSh-së (vazhdim)

Detyrimi i pranuesit për pagim të TVSh-së nuk kushtëzohet nga fatura e furnizimit. Prandaj, në qoftë se pranuesi nuk e pranon faturën e furnizimit, ai prapë duhet të deklarojë këtë shumë në Deklaratën e TVSh-së për periudhën përkatëse tatimore dhe të paguajë TVSh-në.



Lindja e detyrimit në periudhën Tatimore

- Kjo shpjegohet në Nenin 22 të Ligjit për TVSH se kur TVSh bëhet e detyrueshme.
- Në bazë të kësaj dispozite, TVSh bëhet e detyrueshme në momentin kur kryhet njëri nga aktivitetet në vijim, ai që është më i hershmi:
 - Kryerja e shërbimeve;
 - Lëshimi i faturave
 - Pagesa apo pagesa e pjesërishme e bërë para se të lëshohet fatura;
- Furnizimi i vazhdueshëm me shërbime pas një periudhe kohore duhet të njihet si i kompletuar së paku në interval një mujor.



Përfshirja e TVSh-së së ngarkueshme në deklaratën e TVSh-së

- Pranuesi i shërbimit duhet të përfshijë tatimin e llogaritur të TVSh së detyrueshme për furnizimet e shërbimeve nga furnizuesi që nuk është i themeluar në Kosovë.
- Pra, pranuesi i shërbimit, në deklaratën e TVSh-së duhet ta paraqes TVSh-në e llogaritur, në pjesën e shitjeve në rubrikën 28 – Blerjet që i nënshtrohen Ngarkesës së kundërt.



E drejta e zbritjes së TVSH-së

- Pranuesi me të njëjtën deklaratë të TVSh-së ka të drejtë të zbres shumën e TVSh-së të deklaruar si TVSh e llogaritur në pajtim me Kreun XIII të Ligjit mbi TVSh-në.
- Nëse pranuesi nuk ka pranuar faturë nga furnizuesi, kushti i referuar në Nenin 37 paragrafi 2.1 në lidhje me lejimin e zbritjes që e lejon të bëjë këtë vetëm nëse tatimpaguesi e posedon faturën e furnizimit, nuk bënë të aplikohet në lidhje me zbritjen e TVSH së llogaritur që është llogaritur për furnizimet e pranuar nga furnizuesi që nuk e ka njësinë të themeluar në Kosovë.



E drejta e zbritjes së TVSH-së, nëse nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH për shërbimet e blera jashtë Kosovës

- a. Kur tatimpaguesi nuk aplikon ngarkesën e kundërt për TVSH për shërbimet e blera jashtë vendit, ndërsa faturën tatimore **e evidenton** në libra/kontabilitet, dhe
- b. Kur tatimpaguesi nuk aplikon ngarkesën e kundërt për TVSH për shërbimet e blera jashtë vendit, ndërsa faturën tatimore **NUK e evidenton** në libra/kontabilitet;



E drejta e zbritjes së TVSH-së, kur nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH, ndërsa fatura është e evidentuar në libra/kontabilitet

Në rastin kur tatimpaguesi (pranuesi i shërbimit në Kosovë), faturën e shërbimit të pranuar nga një person i tatueshëm jashtë Kosovës (i cili nuk është i themeluar në Kosovë), e evidenton në libra/kontabilitet, por për këtë faturë (shërbim) nuk aplikon ngarkesën e kundërt për TVSH (me arsyen se po të kishte aplikuar nuk do të kishte efekt tatimor, pasi që TVSH e llogaritur do të minusohet me TVSH të zbritshme, nënkuptohet kur është e drejta e plotë e TVSH-së së zbritshme), aplikohet TVSH e llogaritur, si dhe njohja e zbritjes së plotë të TVSH-së.



E drejta e zbritjes së TVSH-së, kur nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH, ndërsa fatura është e evidentuar në libra/kontabilitet

Tatimpaguesi i cili nuk zbaton mekanizmin e aplikimit të ngarkesës së kundërt për TVSH, por faturën e shërbimit e evidenton në libra/kontabilitet, e ka të drejtën e zbritjes së TVSH-së në po të njëjtën periudhë tatimore, pa u kufizuar në afatin kohor të përcaktuar në nenin 38, paragrafin 2 të Ligjit nr. 05/L-037 për TVSH.

Në raste të tilla, për mos aplikimin e ngarkesës së kundërt, Administrata Tatimore do të aplikoj ndëshkimet e përcaktuara me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.



E drejta e zbritjes së TVSH-së, kur nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH, si dhe fatura **NUK** është e evidentuar në libra/kontabilitet

Në rastin kur tatimpaguesi (pranuesi i shërbimit në Kosovë), faturën e shërbimit të pranuar nga një person i tatueshëm jashtë Kosovës (i cili nuk është i themeluar në Kosovë), NUK e evidenton në libra/kontabilitet, si dhe për këtë faturë (shërbim) nuk aplikon ngarkesën e kundërt për TVSH (me arsyen se po të kishte aplikuar nuk do të kishte efekt tatimor, pasi që TVSH e llogaritur do të minusohet me TVSH të zbritshme, nënkuptohet kur është e drejta e plotë e TVSH-së së zbritshme), aplikohet TVSH e llogaritur, si dhe njohja e zbritjes së plotë të TVSH-së.



E drejta e zbritjes së TVSH-së, kur nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH, si dhe fatura **NUK** është e evidentuar në libra/kontabilitet

Tatimpaguesi i cili nuk zbaton mekanizmin e aplikimit të ngarkesës së kundërt për TVSH, si dhe faturën e shërbimit NUK e evidenton në libra/kontabilitet, e ka të kufizuar të drejtën e zbritjes së TVSH-së, ashtu siç është përcaktuar në nenin 38, paragrafin 2 të Ligjit nr. 05/L-037 për TVSH.



E drejta e zbritjes së TVSH-së, kur nuk është aplikuar ngarkesa e kundërt për TVSH, si dhe fatura **NUK** është e evidentuar në libra/kontabilitet

Në rastin kur tatimpaguesi nuk zbaton ngarkesën e kundërt në lidhje me TVSH, si dhe faturën nuk e evidenton në libra/kontabilitet, nënkupton se ky tatimpagues edhe deklarin për Tatim në të Ardhura Personale apo Tatim në të Ardhura të Korporatave, nuk e ka deklaruar saktë.

Në raste të tilla, për mos aplikimin e ngarkesës së kundërt për TVSH dhe mos evidentim të faturës, Administrata Tatimore, do të aplikoj ndëshkimet e përcaktuara me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.



Regjistrimi i TVSh-së dhe përfaqësuesi tatimor

Kur zbatohet procedura e ngarkesës së kundërt dhe si pasojë pranuesi është i obliguar të paguajë TVSh-në, në këtë rast furnizuesi nuk është i obliguar të regjistrohet në Kosovë ose të caktojë përfaqësues tatimor.



Kur pranuesi NUK ËSHTË i regjistruar për TVSh në Kosovë

Kur një person i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë kryen një furnizim ku vendi i furnizimit të shërbimit konsiderohet të jetë Kosova, tek një person i cili **nuk është i regjistruar për TVSh në Kosovë**, furnizuesi është i obliguar të regjistrohet për TVSh në Kosovë, para se ta kryejë furnizimin.



Kur pranuesi NUK ËSHTË i regjistruar për TVSh në Kosovë (vazhdim)

- Furnizuesi që nuk është i themeluar në Kosovë duhet të emëroj një përfaqësues tatimor. Furnizuesi duhet të regjistrohet në emrin e tij dhe me emrin e përfaqësuesit tatimor brenda pesë ditëve pas emërimit të përfaqësuesit tatimor dhe para se të fillojë aktivitetin ekonomik në Kosovë.
- Përfaqësuesi tatimor është i detyruar të paguaj TVSh-në për furnizimet në Kosovë për personin e tatueshëm që e përfaqëson për furnizimet që i bënë tek personat që nuk janë të regjistruar për TVSh në Kosovë.




Përmbledhje

Furnizuesi i shërbimit Pranuesi i shërbimit TVSH

Person jo i tatueshëm	Person i tatueshëm Person jo i tatueshëm	Nuk ka implikime në - TVSH
Person i tatueshëm	Person i tatueshëm	Nëse vendi i furnizimit të shërbimit është Kosova, aplikohet Ngarkesa e kundërt, Ligji Nr. 05/L-037 për TVSH, Neni 52.1.2 + TVSH
Person i tatueshëm	Person jo i tatueshëm	Nëse vendi i furnizimit të shërbimit është Kosova, emërohet Përfaqësuesi tatimor, Ligji Nr. 05/L-037 për TVSH, Neni 52.5 + TVSH



Ngarkesa e Kundërt



Përmbledhje

- Nëse aplikohet Ngarkesa e Kundërt, Person i obliguar për të paguar TVSh-në bëhet **Pranuesi i shërbimit**.
- Furnizuesi duhet të lëshojë një faturë në të cilën nuk prezentohet TVSh-ja (VAT – ID), por me referencë për “Revers Charge”.
- Pranuesi i shërbimit e llogaritë TVSh-në me 18% mbi vlerën e faturës së pranuar nga furnizuesi.
- Detyrimi për TVSh lind eventualisht edhe pa faturë.
- Zbritja e TVSh-së së zbritshme parimisht në të njëjtën shumë dhe në të njëjtin muaj si TVSh-ja



Përmbledhje

- [VSHP 3 2017 për të drejten e zbritjes së TVSH në aplikimin e Ngarkesës së kundërt 22.08.2017.pdf](#)



Vizitoni ueb faqen e ATK-së
www.atk-ks.org

**Ju faleminderit për
vëmendje!**



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo